



02-NB-NU  
16-12953A  
06/12/2018  
REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

## ***KONTRATË SHËRBIMI***

**KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"**VICTORIA TOURS " SH.P.K** nga Gjilani (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

Transporti për vizitë në Shqipëri për Ardhmëria 1 dhe Intexh

me numër Identifikues **651-18-8985-2-3-6**

me numër të prokurimit **GL 651 18 087 236**

Neni 1              Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Transporti për vizitë në Shqipëri për Ardhmëria 1 dhe Intexh - sipas përshkrimit në aneksin 1 specifikimet teknike të detyrueshme

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët dhe përfundon me me një afat prej 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **30** ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i realizimit të transportit do të jetë: do të jetë relacion i **Kosovo-Shqipri - Gjilan-Tiran Trina – Durres, Berat-Durres, Durres -Kruj**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2              Ligji i aplikueshëm

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### Neni 3              Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,482.00 €; Njëmi jë e katërqindë e tetëdhjetë e dy Euro. Zero zero cent.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borsht Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

#### Neni 4              Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### Neni 6              Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet të gjitha aspektet të plotësoj specififikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### Neni 7              Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *shërbimeve*.

#### Neni 8              Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës

së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### Neni 9                   **Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### Neni 10                   **Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11                   **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykalë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjyktimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjyktimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12                   **Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktesuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsyet që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arribet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën Themelore në prishtinë – Departamenti Ekonomik në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14                    **Komunikimi**


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap **Titullin e kontratës** dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen **Shqipe** në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Autoritetin Kontraktues**

<b>Emri:</b>	Izet Kurteshi	<b>Emri:</b>	Naser Korqa
<b>Pozita:</b>	U.D Drejtore i Zyrës së Prokurimit	<b>Pozita:</b>	I autorizuar-Zyrtarë përgjegjëse e prokurimit
<b>Nënskrimi:</b>		<b>Nënskrimi:</b>	
<b>Data:</b>	05.12.2018	<b>Data:</b>	05.12.2018
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

**Për Kontraktorin**

<b>Emri:</b>	Mustaf Dubova
<b>Pozita:</b>	Drejtore
<b>Nënskrimi:</b>	
<b>Data:</b>	05.12.2018
<b>Vula:</b>	